

DEPARTAMENTI I ANALIZAVE EKONOMIKE DHE STATISTIKAVE BUJQËSORE

**Analiza për shkëmbimin tregtar të prodhimeve bujqësore
2020-2021**

Shtator, 2022

Tabela e përmbajtjes

| | |
|--|-----------|
| Lista e figurave | 2 |
| Lista e tabelave | 2 |
| Hyrje..... | 4 |
| Metodologjia..... | 5 |
| Përmbledhja..... | 6 |
| 1 Eksport - Importi i produkteve bujqësore..... | 7 |
| 1.1 Eksport - Importi i produkteve bujqësore sipas grupit të shteteve | 9 |
| 1.1.1 Eksport - Importi me 27 vendet e BE-së..... | 10 |
| 1.1.2 Eksport - Importi me vendet e CEFTA-s | 15 |
| 1.1.3 Eksport - Importi me Vendet e tjera | 20 |
| Aneks 1: Vlera e eksport - importit të produkteve bujqësore në nivel katër shifror - CN4..... | 26 |
| Aneks 2: Sasia e eksport - importit të produkteve bujqësore në nivel katër shifror - CN4..... | 33 |

Lista e figurave

| | |
|---|----|
| Figura 1: Eksporti - Importi dhe bilanci tregtar, vlera në mil. €..... | 7 |
| Figura 2: Shkëmbimi tregtar sipas grupit të shteteve, vlera në mil. € | 10 |

Lista e tabelave

| | |
|---|----|
| Tabela 1: Produktet më të eksportuara në vitin 2020, vlera në '000 €..... | 8 |
| Tabela 2: Produktet më të eksportuara në vitin 2021, vlera në '000€..... | 8 |
| Tabela 3: Shkëmbimi tregtar sipas grupit të shteteve, vlera në mil. € | 9 |
| Tabela 4: Eksport - Importi me 27 vendet e BE-së për kapitujt 01-24, vlera në '000 €..... | 11 |
| Tabela 5: Eksport - Importi sipas shteteve të BE-së, vlera në '000 € | 12 |

| | | |
|------------|--|----|
| Tabela 6: | Produktet bujqësore më të eksportuar në BE që kanë pasur rritje në 2020-2021, vlera në '000 €..... | 13 |
| Tabela 7: | Produktet bujqësore të eksportuara në BE që kanë pasur rënie në 2020-2021, vlera në '000 €..... | 13 |
| Tabela 8: | Produktet bujqësore të importuar nga BE që kanë pasur rënie në 2020-2021, vlera në '000 €..... | 14 |
| Tabela 9: | Produktet bujqësore të importuar nga BE që kanë pasur rritje në 2020-2021, vlera në '000 €..... | 15 |
| Tabela 10: | Eksport - Importi me vendet e CEFTA-s për kapitujt 01-24, vlera në '000 €..... | 16 |
| Tabela 11: | Eksporti në shtetet e CEFTA-s për kapitujt 01-24, vlera në '000 €..... | 17 |
| Tabela 12: | Importi nga shtetet e CEFTA-s për kapitujt 01-24, vlera në '000 €..... | 17 |
| Tabela 13: | Produktet bujqësore më të eksportuara në CEFTA që kanë pasur rritje në vitin 2020-2021, vlera në '000 €..... | 18 |
| Tabela 14: | Produktet bujqësore të eksportuara në CEFTA që kanë pasur rënie në vitin 2020-2021, vlera në '000 €..... | 19 |
| Tabela 16: | Produktet bujqësore më të importuara nga CEFTA që kanë pasur rritje në vitin 2020-2021, vlera në '000 € | 19 |
| Tabela 17: | Eksporti - Importi me Vendet e tjera për kapitujt 01-24, vlera në '000 €..... | 21 |
| Tabela 18: | Eksporti në Vendet e tjera sipas shteteve, për kapitujt 01-24, vlera në '000 €..... | 22 |
| Tabela 19: | Produktet bujqësore të eksportuar në Vendet tjera që kanë pasur rritje në 2020-2021, vlera në '000 €..... | 23 |
| Tabela 20: | Produktet bujqësore të eksportuar në Vendet tjera që kanë pasur rënie në 2020-2021, vlera në '000 € | 23 |
| Tabela 21: | Importi me Vendet e tjera sipas shteteve, për kapitujt 01-24, vlera në '000 €..... | 24 |
| Tabela 22: | Produktet bujqësore të importuara nga Vendet tjera që kanë pasur rritje në 2020-2021, vlera në '000€..... | 24 |
| Tabela 23: | Produktet bujqësore të importuara nga Vendet tjera që kanë pasur rënie në vitin 2020-2021, vlera në '000€..... | 25 |
| Tabela 24: | Eksporti - Importi i produkteve bujqësore 2020-2021, vlera në '000€..... | 26 |
| Tabela 25: | Eksporti - Importi i produkteve bujqësore 2020-2021, sasia në tonë..... | 33 |

Hyrje

Të dhënat e tregtisë (statistikat e importit dhe eksportit) paraqesin gjendjen e tregtisë ndërkombëtare të organizuara sipas periudhës kohore, vendit dhe produkteve, dhe mund të përdoren për të vlerësuar ofertën dhe kërkesën për produkte të veçanta në vende specifike, gjë që është e dobishme jo vetëm për hartuesit e politikave por edhe për kompanitë e ndryshme që merren me eksport dhe import. Përmes të dhënave të tregtisë mund të analizohen tendencat e përgjithshme në tregtinë botërore dhe ndikimin e tyre në industri të veçanta në vend. Qëllimi i kësaj analize është paraqitja në formë më të detajuar të produkteve bujqësore në nivel dy, katër dhe tetë shifror, të dhënat për vitet 2020-2021 dhe ndryshimi i paraqitur mes dy viteve të fundit në vlerë dhe sasi. Prandaj, duke pasur parasysh rëndësinë e informatave të kësaj natyre është përgatitur kjo analizë ku pasqyrohet shkëmbimi tregtar i Kosovës me vendet tjera sa i përket produkteve bujqësore (Sistemi i Harmonizuar Doganor për kapitujt 01-24).

Kjo analizë e përgatitur për shkëmbimin tregtar po ashtu ndihmon në vlerësimin e kërkesës për produkte të caktuara dhe vlerësimin e kërkesës për produktet bujqësore duke marrë parasysh importin dhe eksportin e produkteve bujqësore dhe vendet prej nga ato vijnë.

Njohuritë për orientimin e eksportit në vende të ndryshme sigurojnë më tej informacionet se në cilat vende është realizuar eksporti dhe pastaj varësisht gjendjes momentale hartohen masa të ndryshme në kuadër të zhvillimit të politikave bujqësore në lehtësimin e mëtutjeshëm të eksportit për produkte primare dhe ato të ndërmjetme.

Bazuar në të dhënat e prezantuara, vërejmë se produktet bujqësore të eksportuara aktualisht nga Kosova janë shumëfish më të vogla se sa ato të importuara edhe pse ka tendencë të rritjes, sidomos viteve të fundit.

Përmes kësaj analize është paraqitur vlera dhe sasia e shkëmbimit tregtar si dhe bilancit tregtar për gjithsej produktet bujqësore për kapitujt 01-24, duke filluar nga viti 2005 deri në vitin 2021.

Metodologjia

Baza e të dhënave të shkëmbimit tregtar merret nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Përpunimi i të dhënave për kapitujt 01-24 bëhet nga Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Bazuar në memorandumun e bashkëpunimit në mes MBPZhR-ës dhe ASK-ës është bërë i mundur shfrytëzimi i të dhënave të shkëmbimit tregtar për produkte bujqësore në mënyrë më të detajuar. Këto të dhëna merren në baza mujore nga ASK dhe barten në fajllin e dizajnuar në ACCESS. Fajlli i përmban tabelat që merren për 12 muaj, ku paraqitet përshkrimi i kapitujve, shteteve dhe përshkrimin e kodeve në nivel produkti për kapitujt 01-24. Fajlli përmban edhe pyetësorët (query) që përgatiten nga zyrtarja e lartë e bazës së të dhënave në DAESB. Pyetësori përgatitet sipas muajve dhe po ashtu sipas vitit (12 muaj). Me përgatitje të fajllit baza e të dhënave bartet në "Sistemin Informativ të Integruar Bujqësorë" dhe në këtë mënyrë importohet baza e të dhënave të shkëmbimit tregtar ku kanë qasje administratori dhe analistat (zyrtar të DAESB).

Përmbledhja

Në periudhën 2005-2021 ashtu siç shihet në figurën 1: eksporti i produkteve bujqësore ka shënuar rritje, por rritje më të madhe ka pasur importi, ku në vitin 2005 ishte 285.6 mil. €, ndërsa në vitin 2021 kjo vlerë arriti në 965.6 mil. €, që paraqet rritje për më shumë se 3 herë.

Eksporti po ashtu ka pasur ndryshime në vlerë për periudhën që është prezantuar në figurën në vijim. Në vitin 2005 Kosova ka eksportuar produkte bujqësore në vlerë prej 7.9 mil. €, ndërsa në vitin 2021 kjo vlerë ishte 92.6 mil. €, me rritje të vlerës për më shumë se 12 herë.

Gjithsej eksporti i produkteve bujqësore në vitin 2021 ka pasur rritje për 18.7% krahasuar me vitin 2020, ndërsa importi ka pasur rritje për 26.2%. Mbulueshmëria e importit me eksport në vitin 2021 ishte 9.6%.

Partnerët kryesor të Kosovës ku është realizuar sasia më e madhe e eksportit të produkteve bujqësore janë: Shqipëria me pjesëmarrje prej 28.4%, Maqedonia e Veriut 13.4%, Gjermania 12.9%, Serbia 9.8%, Holanda 3.5%, Italia 3.0% dhe Kroacia 2.7%. Partnerët kryesor të Kosovës nga ku janë importuar më së shumti produkte bujqësore janë: Serbia 15.7%, Turqia 8.3%, Gjermania 7.6%, Polonia 6.9%, Italia dhe Maqedonia e Veriut me nga 6.1%, Kroacia 6.0%, Brazili 4.9%, Sllovenia 3.9% dhe Hungaria 3.5%.


Ndër produktet më të eksportuara në vitin 2021 janë: Ujërat, përfshirë ujërat mineral dhe ujërat me gaz, që përmbajnë ëmbëltues; Birra e bërë nga malti; Kafe e pjekur; Bimë Ephedra dhe pjesë të saj, përfshirë farat dhe frutat, të freskëta, të ftohta, të ngrira ose të thara, qofshin ose jo të prera, të shtypura apo në formë pluhuri si dhe Mish ose të brendshme të ngrënshme të mishit të patës, të rosës dhe të shpendëve guinea të llojit domesticus, të pjekura, të përgatitura ose të konservuara etj.

Kur bëhet fjalë për importin në vitin 2021 produktet më të importuara ishin: Cigare që përmbajnë duhan (përveç atyre me përmbajtje të karafililit); Ujëra, përfshirë ujërat mineral dhe ujërat me gaz, që përmbajnë sheqer, ëmbëltues apo aromatizues shtesë, për konsum të drejtpërdrejtë si pije; Bagëti me peshë > 300 kg, për therrje (përveç mëshqerrave dhe lopëve); Përgatitje ushqimore që nuk përmbajnë nyndyra qumështi, sakarozë, izoglukozë dhe sheqer i bardhë.

1 Eksport - Importi i produkteve bujqësore

Eksporti dhe importi i produkteve bujqësore ka pasur ndryshime gjatë viteve duke filluar nga viti 2005, rritje është shënuar në vlerën e eksportit që nëse krahasojmë me vitin 2020 në vitin 2021 kishte rritje për 18.7%. Për dallim nga eksporti, vlera e importit të produkteve bujqësore ka pasur ndryshime shumë më të mëdha, kështu që nëse e krahasojmë vlerën e importit të vitit 2020 me atë të vitit 2021 rrjedh se importi ka pasur rritje të vlerës për 26.2%.

Figura 1: Eksporti - Importi dhe bilanci tregtar, vlera në mil. €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhr

Produktet më të eksportuara në vitin 2020: Nëse bëjmë krahasimin e pesë (5) produkteve më të eksportuara për vitet 2020 dhe 2021, vërejmë se vlera e produkteve më të eksportuara në vitin 2020 është e ngjashme me ato të vitit 2021, me pak ndryshime. Produktet bujqësore në vitin 2020 në nivel 8 shifror janë paraqitur në tabelën 1: Ujërat dhe ujërat minerale që përmbajnë ëmbëltues; Birra e bërë nga malti; Bimë mjekuese aromatike; Kafe e pjekur (përveç asaj të dekafeinizuar) dhe Mish nga pjesët e organeve të ngrënshme të mishit

të patës, të rosës dhe të shpendëve guinea të llojit domesticus, të pjekura, të përgatitura ose të konservuara etj. Pesë (5) produktet e paraqitura në tabelë përbëjnë 32.2 mil. €, apo 41.2% të vlerës së eksportit të produkteve bujqësore për kapitujt 01-24.

Tabela 1: Produktet më të eksportuara në vitin 2020, vlera në '000 €

| CN8 | Përshkrimi i kodit | 2020 |
|----------|--|--------|
| 22021000 | Ujëra, përfshirë ujërat mineral dhe ujërat me gaz, që përmbajnë ëmbëltues | 13,453 |
| 22030001 | Birra e bërë nga malti, në shishe që mbajnë <= 10 l | 9,056 |
| 12115000 | Bimë Ephedra dhe pjesë të saj, përfshirë farat dhe frutat, të freskëta, të ftohta, të ngrira ose të thara, qofshin ose jo të prera, të shtypura apo në formë pluhuri | 3,880 |
| 09012100 | Kafe e pjekur (përveç asaj të dekafeinizuar) | 3,720 |
| 08112031 | Mjedra, të paziera apo të ziera me avull ose në ujë, të ngrira, pa ëmbëltues | 2,064 |

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Produktet më të eksportuara në vitin 2021: Produktet më të eksportuara në vitin 2021 që kishin vlerë më të madhe, po ashtu në nivel 8 shifror, janë paraqitur në tabelën 2: Ujërat dhe ujërat minerale që përmbajnë ëmbëltues; Birra e bërë nga malti; Kafe e pjekur (përveç asaj të dekafeinizuar); bimë mjekuese aromatike dhe Mish nga pjesët e organeve të ngrëshme të mishit të patës, të rosës dhe të shpendëve guinea të llojit domesticus, të pjekura, të përgatitura ose të konservuara etj. Pesë (5) produktet e paraqitura në tabelë përbëjnë 37.5 mil. €, apo 40.5% të vlerës së eksportit të produkteve bujqësore.

Tabela 2: Produktet më të eksportuara në vitin 2021, vlera në '000€

| CN8 | Përshkrimi i kodit | 2021 |
|----------|--|--------|
| 22021000 | Ujëra, përfshirë ujërat mineral dhe ujërat me gaz, që përmbajnë ëmbëltues | 17,856 |
| 22030001 | Birra e bërë nga malti, në shishe që mbajnë <= 10 l | 9,476 |
| 09012100 | Kafe e pjekur (përveç asaj të dekafeinizuar) | 3,834 |
| 12115000 | Bimë Ephedra dhe pjesë të saj, përfshirë farat dhe frutat, të freskëta, të ftohta, të ngrira ose të thara, qofshin ose jo të prera, të shtypura apo në formë pluhuri | 3,328 |
| 16023929 | Mish nga pjesët e organeve të ngrëshme të mishit të patës, të rosës dhe të shpendëve guinea të llojit domesticus, të pjekura, të përgatitura ose të konservuara etj. | 3,055 |

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

1.1 Eksport - Importi i produkteve bujqësore sipas grupit të shteteve

Vlera e eksportit të produkteve bujqësore në 27 vendet e BE-së në vitin 2021 ishte 31.7 mil. €, që në krahasim me vitin 2020 kishte rritje për 8.0%. Vlera e importit të produkteve bujqësore nga 27 vendet e BE-së në vitin 2021 ishte 467.0 mil. €, ku shfaqet një rritje për dallim nga viti 2020 për 15.4%, me bilanc tregtar negativ në vlerë prej 435.3 mil. €. Mbulueshmëria e importit me eksport në vitin 2021 ishte 6.8%.

Tabela 3: Shkëmbimi tregtar sipas grupit të shteteve, vlera në mil. €

| Grupi i shteteve | Eksport | | Ndryshimi, në (%) 2021/2020 | Import | | Ndryshimi, në (%) 2021/2020 | Balanci tregtar | | Mbulueshmëria e importit me eksport 2020, në (%) | Mbulueshmëria e importit me eksport 2021, në (%) |
|------------------|-------------|-------------|--------------------------------|--------------|--------------|--------------------------------|-----------------|---------------|---|---|
| | 2020 | 2021 | | 2020 | 2021 | | 2020 | 2021 | | |
| BE | 29.4 | 31.7 | 8.0 | 404.6 | 467.0 | 15.4 | -375.3 | -435.3 | 7.3 | 6.8 |
| CEFTA | 41.1 | 51.6 | 25.4 | 183.4 | 266.6 | 45.4 | -142.2 | -215.0 | 22.4 | 19.4 |
| Të tjera | 7.6 | 9.3 | 23.2 | 177.3 | 232.0 | 30.8 | -169.8 | -222.6 | 4.3 | 4.0 |
| Gjithsej | 78.1 | 92.6 | 18.6 | 765.4 | 965.6 | 26.2 | -687.3 | -872.9 | 10.2 | 9.6 |

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Vlera e eksportit të produkteve bujqësore në vendet e CEFTA-s në vitin 2021 arriti në 51.6 mil. €, që ishte rritje e vlerës së eksportit në krahasim me vitin 2020 për 25.4%.

Vlera e importit nga vendet e CEFTA-s në vitin 2021 ishte 266.6 mil. €, me rritje për 45.4% për dallim nga viti 2020, dhe me bilanc tregtar negativ në vlerë prej 215.0 mil. €. Mbulueshmëria e importit me eksport ishte 19.4%.

Eksporti në vendet e tjera në vitin 2021 kishte vlerë 9.3 mil. €, ku shfaqet rritje për 22.4% në krahasim me vitin 2020, ndërsa importi nga vendet tjera në vitin 2021 paraqitet në vlerë prej 232.0 mil. €, ku vërehet një rritje për 30.8% për dallim nga viti 2020.

Figura 2: Shkëmbimi tregtar sipas grupit të shteteve, vlera në mil. €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

1.1.1 Eksport - Importi me 27 vendet e BE-së

Gjithsej vlera e produkteve bujqësore të eksportuara në vitin 2021 në 27 vendet e BE-së ishte 31.7 mil. €, që në krahasim me vitin 2020 ka pasur rritje për 8.0%, ndërsa vlera e importit në vitin 2021 ishte 467.0 mil. €, që paraqet rritje në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 për 15.4%. Rritje më të madhe të vlerës së eksportit në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 ka pasur në produktet që bëjnë pjesë në Kapitullin e 16 (Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut apo prej krustaceve, etj.) 242%, ndërsa rritje më e madhe e vlerës së importit paraqitet në kapitullin 01 (Kafshët e gjalla) me rritje prej 65.6%.

Tabela 4: Eksport - Importi me 27 vendet e BE-së për kapitujt 01-24, vlera në '000 €

| CN2 | Përshkrimi | Eksport | | Ndryshimi | Import | | Ndryshimi |
|-----|--|---------------|---------------|---------------|----------------|----------------|---------------|
| | | 2020 | 2021 | 2021/2020 (%) | 2020 | 2021 | 2021/2020 (%) |
| 1 | Kafshët e gjalla | - | - | | 20,923 | 34,651 | 65.6 |
| 2 | Mishi dhe pjesët e ngrënshme të kafshëve | - | - | | 18,143 | 24,651 | 35.9 |
| 3 | Peshqit dhe krustacet, molusqet dhe kafshët e tjera jokurrizore ujore | - | - | | 1,622 | 2,098 | 29.3 |
| 4 | Produkte të qumështit; vezët; mjalti natyral | 3 | 10 | 278.5 | 40,731 | 47,201 | 15.9 |
| 5 | Produkte me origjinë shtazore, të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër | - | - | | 120 | 127 | 5.8 |
| 6 | Drunjtë dhe bimët e tjera; zhardhokët; lulet dhe gjethet dekorative | 803 | 386 | -51.92 | 3,934 | 4,444 | 13.0 |
| 7 | Perimet e ngrënshme dhe disa lloje të rrënjëve dhe zhardhokëve | 5,522 | 3,928 | -28.86 | 6,443 | 7,202 | 11.8 |
| 8 | Pemët dhe aroret e ngrënshme | 4,939 | 4,244 | -14.06 | 8,793 | 8,882 | 1.0 |
| 9 | Kafe, çaj, krem dhe erëza | 2,648 | 2,480 | -6.36 | 9,127 | 11,431 | 25.2 |
| 10 | Drithërat | 164 | 85 | -48.17 | 17,573 | 8,549 | -51.4 |
| 11 | Produktet e industrisë bluajtëse; maja e elbit apo drithërave tjera | 69 | 64 | -7.05 | 8,432 | 7,264 | -13.9 |
| 12 | Farat vajore; bimët industriale apo medicinale; kashta dhe foragjere | 2,995 | 3,025 | 1.01 | 2,847 | 3,174 | 11.5 |
| 13 | Lënda e trashë ngjitëse nga të çarat e drunjëve | - | - | | 286 | 301 | 5.2 |
| 14 | Materialet vegjetale që përdoren për thurje | - | 8 | | 7 | 8 | 8.9 |
| 15 | Vajra dhe yndyrat bimore apo shtazore dhe produktet e nxjerra nga to | 313 | 277 | -11.52 | 15,205 | 14,964 | -1.6 |
| 16 | Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut apo prej krustaceve, etj. | 892 | 3,055 | 242.38 | 19,348 | 19,251 | -0.5 |
| 17 | Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij | 173 | 161 | -6.99 | 19,846 | 14,947 | -24.7 |
| 18 | Kakao dhe përgatitjet prej kakaos | 335 | 392 | 16.94 | 18,346 | 21,611 | 17.8 |
| 19 | Përgatitjet prej drithërave, miellit, niseshtes apo qumështit etj. | 619 | 766 | 23.7 | 34,865 | 45,052 | 29.2 |
| 20 | Përgatitjet prej perimeve, frutave, arroveve apo pjesëve të tjera të bimëve | 3,294 | 4,104 | 24.57 | 13,336 | 17,686 | 32.6 |
| 21 | Përgatitje të ndryshme të ngrënshme | 134 | 132 | -1.64 | 51,234 | 59,343 | 15.8 |
| 22 | Pijet, alkoolet dhe uthulla | 6,457 | 8,595 | 33.1 | 38,253 | 43,998 | 15.0 |
| 23 | Mbetjet nga industritë ushqimore; Ushqim foragjer i përgatitur për kafshë | - | - | | 9,059 | 8,829 | -2.5 |
| 24 | Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit. | - | - | | 46,169 | 61,332 | 32.8 |
| | Gjithsej | 29,360 | 31,711 | 8.01 | 404,641 | 466,997 | 15.4 |

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Në vitin 2021, pjesëmarrje më të madhe në vlerën e eksportit të produkteve bujqësore në BE ka pasur: Gjermania me 37.6%, vijuar nga Holanda 10.2% dhe Bullgaria 9.2%, ndërsa në vlerën e importit të produkteve bujqësore nga BE, në vitin 2021 pjesëmarrje më të madhe kishte Gjermania 15.8%, Polonia 14.2% si dhe Italia dhe Kroacia me pjesëmarrje prej 12%.

Tabela 5: Eksport - Importi sipas shteteve të BE-së, vlera në '000 €

| Shteti | 2020 | 2021 | Pjesëmarrja e shtetit, 2021 | Ndryshimi 2021/2020 | 2020 | 2021 | Pjesëmarrja e shtetit, 2021 | Ndryshimi 2021/2020, |
|-----------------|---------------|---------------|-----------------------------|---------------------|----------------|----------------|-----------------------------|----------------------|
| | Eksport | Eksport | (%) | (%) | Import | Import | (%) | (%) |
| Austri | 1,363 | 1,992 | 6.3 | 46 | 19,628 | 24,766 | 5.3 | 26 |
| Belgjikë | 462 | 421 | 1.3 | -9 | 3,403 | 3,249 | 0.7 | -5 |
| Bullgari | 2,758 | 2,923 | 9.2 | 6 | 36,033 | 23,805 | 5.1 | -34 |
| Danimarkë | | 75 | 0.2 | | 1,311 | 1,858 | 0.4 | 42 |
| Estoni | 46 | 28 | 0.1 | -40 | 42 | 175 | 0.0 | 312 |
| Finlandë | 102 | 130 | 0.4 | 28 | 27 | 45 | 0.0 | 67 |
| Francë | 857 | 741 | 2.3 | -14 | 12,394 | 8,745 | 1.9 | -29 |
| Gjermani | 11,603 | 11,910 | 37.6 | 3 | 56,248 | 73,460 | 15.7 | 31 |
| Greqi | 38 | 191 | 0.6 | 401 | 18,819 | 19,931 | 4.3 | 6 |
| Holandë | 2,557 | 3,248 | 10.2 | 27 | 16,268 | 23,770 | 5.1 | 46 |
| Hungari | 335 | 403 | 1.3 | 20 | 28,869 | 33,415 | 7.2 | 16 |
| Irlandë | | | | | 1,325 | 1,837 | 0.4 | 39 |
| Itali | 3,140 | 2,772 | 8.7 | -12 | 48,245 | 58,679 | 12.6 | 22 |
| Kroaci | 1,953 | 2,510 | 7.9 | 29 | 50,313 | 57,522 | 12.3 | 14 |
| Letoni | 9 | 140 | 0.4 | 1,435 | 205 | 92 | 0.0 | -55 |
| Lituani | 2 | 4 | 0.0 | 100 | 1,107 | 1,869 | 0.4 | 69 |
| Luksemburg | 100 | 140 | 0.4 | 40 | | | | |
| Maltë | 12 | 182 | 0.6 | 1,389 | | 2 | | |
| Poloni | 569 | 276 | 0.9 | -52 | 52,199 | 66,288 | 14.2 | 27 |
| Portugali | | 2 | 0.0 | | 226 | 287 | 0.1 | 27 |
| Qipro | | | | | 79 | 86 | 0.0 | 8 |
| Rep. Çeke | 106 | 189 | 0.6 | 78 | 5,945 | 7,243 | 1.6 | 22 |
| Rumani | 1,178 | 952 | 3.0 | -19 | 11,126 | 15,095 | 3.2 | 36 |
| Slloveni | 489 | 622 | 2.0 | 27 | 34,295 | 38,207 | 8.2 | 11 |
| Sllovaki | 29 | 58 | 0.2 | 100 | 2,172 | 1,126 | 0.2 | -48 |
| Spanjë | | | | | 3,821 | 4,917 | 1.1 | 29 |
| Suedi | 1,653 | 1,803 | 5.7 | 9 | 543 | 532 | 0.1 | -2 |
| Gjithsej | 29,360 | 31,711 | 100.0 | 8 | 404,641 | 466,997 | 100 | 15 |

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Eksperti i produkteve bujqësore në vendet e BE-së

Produktet bujqësore të eksportuara në vendet e BE-së që kanë pasur rritje në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020

Vlera e eksportit të produkteve bujqësore në vendet e BE-së në vitin 2021 ka shënuar rritje krahasuar me vitin 2020 për 8.0 % me ndryshime në vlerë për produktet bujqësore në kapituj 01-24. Në tabelën nr.6, janë paraqitur kapitujt kryesor që kanë shënuar rritje në vlerë në krahasim me vitin 2020:

Tabela 6: Produktet bujqësore më të eksportuar në BE që kanë pasur rritje në 2020-2021, vlera në '000 €

| CN2 | Përshkrimi i kodit | Ekspert 2020 | Ekspert 2021 | Ndryshimi 2021/2020 (%) |
|-----|---|--------------|--------------|-------------------------|
| 16 | Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut etj. | 892 | 3,055 | 242 |
| 19 | Përgatitjet prej drithërave, miellit, niseshtes etj. | 619 | 766 | 24 |
| 20 | Përgatitjet prej perimeve, frutave, arroveve etj. | 3,294 | 4,104 | 25 |
| 22 | Pijet, alkoolet dhe uthulla. | 6,457 | 8,595 | 33 |

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Produktet bujqësore të eksportuara në vendet e BE-së, që kanë pasur rënie në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020

Vlera e eksportit të produkteve bujqësore sipas kapitujve që kanë pasur rënie janë paraqitur në vijim: kapitulli 06 (Drunjtë dhe bimët e tjera dhe gjethet dekorative) në vitin 2021 kishte 52% rënie krahasuar me vitin 2020, duke vazhduar me kapitullin 07 (Perimet e ngrëshme dhe disa lloje të zhardhokëve) me rënie prej 29%, kapitulli 08 (Pemët dhe aroret e ngrëshme) 14% dhe kapitulli 10 (Drithërat) me 48%.

Tabela 7: Produktet bujqësore të eksportuara në BE që kanë pasur rënie në 2020-2021, vlera në '000 €

| CN2 | Përshkrimi i kodit | Ekspert 2020 | Ekspert 2021 | Ndryshimi 2021/2020 (%) |
|-----|---|--------------|--------------|-------------------------|
| 06 | Drunjtë dhe bimët e tjera; lulet dhe gjethet dekorative | 803 | 386 | -52 |
| 07 | Perimet e ngrëshme dhe disa lloje të zhardhokëve | 5,522 | 3,928 | -29 |
| 08 | Pemët dhe aroret e ngrëshme | 4,939 | 4,244 | -14 |
| 10 | Drithërat | 164 | 85 | -48 |

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Importi i produkteve bujqësore nga vendet e BE-së

Produktet bujqësore të importuara nga vendet e BE-së që kanë pasur rënie në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020

Vlera e importit të produkteve bujqësore nga vendet e BE-së në vitin 2021 ka shënuar rritje, krahasuar me vitin 2020 për 15.4%. Ka pasur produkte që përfshihen në kapituj të ndryshëm që kanë pasur rënie në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020. Janë përzgjedhur kapitujt që kanë pasur rënie më të theksur ashtu siç janë paraqitur në tabelën në vijim: Kapitulli 10 (drithërat) në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020 pësoi rënie për 51%; Kapitulli 11 (produktet e industrisë bluajtëse, maja e elbit apo drithërave tjera, niseshte, inulinë, gluten gruri) kishte rënie për 14%; Kapitulli 15 (vajra dhe yndyrat bimore apo shtazore dhe produktet e nxjerra nga to) 2%; Kapitulli 17 (sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij) 25% dhe Kapitulli 23 (mbetjet nga industritë ushqimore, ushqim foragjer i përgatitur për kafshë) kishin rënie për 3%. Këto produkte të shfaqura në tabelën 6 përbëjnë 58.8% të importit nga BE.

Tabela 8: Produktet bujqësore të importuar nga BE që kanë pasur rënie në 2020-2021, vlera në '000 €

| CN2 | Përshkrimi i kodit | Importi 2020 | Importi 2021 | Ndryshimi 2021/2020 (%) |
|-----|--|--------------|--------------|-------------------------|
| 10 | Drithërat | 17,573 | 8,549 | -51 |
| 11 | Produktet e industrisë bluajtëse, etj. | 8,432 | 7,264 | -14 |
| 15 | Vajra dhe yndyrat bimore apo shtazore dhe produktet e nxjerra nga to | 15,205 | 14,964 | -2 |
| 17 | Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij. | 19,846 | 14,947 | -25 |
| 23 | Mbetjet nga industritë ushqimore, etj. | 9,059 | 8,829 | -3 |

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZHR

Produktet bujqësore të importuara nga vendet e BE-së që kanë pasur rritje në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020

Vlera e importit ka pasur rritje në Kapitullin 01 (Kafshët e gjalla) për 66%; Kapitulli 02 (Mishi dhe pjesët e ngrënshme të kafshëve) 36%; Kapitulli 03 (Peshqit dhe krustacet, molusqet etj) 29%; Kapitulli 19 (Përgatitjet prej drithërave apo prej brumërave) ka pasur rritje për 29% dhe Kapitulli i 20 (Përgatitjet prej perimeve, frutave, arroveve apo pjesëve të tjera të bimëve) kishte rritje në vlerë për 33%. Produktet e paraqitura në kapitujt e lartë cekur përbëjnë 52% të vlerës së importit të produkteve bujqësore në BE.

Tabela 9: Produktet bujqësore të importuar nga BE që kanë pasur rritje në 2020-2021, vlera në '000 €

| CN2 | Përshkrimi i kodit | Importi 2020 | Importi 2021 | Ndryshimi 2021/2020 (%) |
|-----|--|--------------|--------------|-------------------------|
| 01 | Kafshët e gjalla | 20,923 | 34,651 | 66 |
| 02 | Mishi dhe pjesët e ngrënshme të kafshëve | 18,143 | 24,651 | 36 |
| 03 | Peshqit dhe krustacet, molusqet etj | 1,622 | 2,098 | 29 |
| 19 | Përgatitjet prej drithërave apo prej brumërave | 34,865 | 45,052 | 29 |
| 20 | Përgatitjet prej perimeve, frutave, arroveve etj | 13,336 | 17,686 | 33 |

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZHR

1.1.2 Eksport - Importi me vendet e CEFTA-s

Gjithsej vlera e produkteve bujqësore të eksportuara në vitin 2021 në vendet nënshkruese të marrëveshjes së CEFTA-s ishte 51.6 mil. €, që në krahasim me vitin 2020 ka pasur rritje për 25%. Vlera e importit në vitin 2021 kishte vlerë 266.6 mil. €, që në krahasim me vitin 2020 ka pasur rritje për 45.4%. Rritje më të madhe të eksportit në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 ka pasur në produktet që bëjnë pjesë në kapitullin e 16 (Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut apo prej krustaceve, etj.) 242%, ndërsa rritje më të madhe të vlerës së importit paraqitet në kapitullin 01 (Kafshët e gjalla) me rritje prej 65.6%.

Tabela 10: Eksport - Importi me vendet e CEFTA-s për kapitujt 01-24, vlera në '000 €

| CN2 | Përshkrimi i kodit | Eksport | | | Import | | |
|-----|--|---------------|---------------|---------------------------|----------------|----------------|---------------------------|
| | | 2020 | 2021 | Ndryshimi 2021/2020(%) | 2020 | 2021 | Ndryshimi 2021/2020(%) |
| 01 | Kafshët e gjalla | | | | 9,313 | 14,635 | 57 |
| 02 | Mishi dhe pjesët e ngrënshme të kafshëve | 337 | 654 | 94 | 1,211 | 1,846 | 52 |
| 03 | Peshqit dhe krustacet, molusqet dhe kafshët e tjera jokurrizore ujore | 111 | 216 | 95 | 511 | 1,025 | 101 |
| 04 | Produkte të qumështit; vezët; mjalti natyral; | 701 | 1,026 | 46 | 9,333 | 10,341 | 11 |
| 05 | Produkte me origjinë shtazore | 4 | 118 | 3,210 | 36 | 92 | 156 |
| 06 | Drunjtë dhe bimët e tjera; lulet e prera dhe gjethet dekorative | 58 | 102 | 76 | 1,397 | 1,617 | 16 |
| 07 | Perimet e ngrënshme dhe disa lloje të rrënjëve dhe zhardhokëve | 3,083 | 1,988 | -36 | 9,863 | 12,118 | 23 |
| 08 | Pemët dhe arrotet e ngrënshme; lëvozhga e agrumeve etj. | 4,213 | 6,614 | 57 | 9,096 | 10,885 | 20 |
| 09 | Kafe, çaj, krem dhe erëza | 2,528 | 2,689 | 6 | 1,522 | 1,880 | 24 |
| 10 | Drithërat | 349 | 420 | 20 | 23,144 | 29,742 | 29 |
| 11 | Produktet e industrisë bluajtëse; maja e elbit apo drithërave tjera etj. | 814 | 1,542 | 89 | 4,465 | 2,869 | -36 |
| 12 | Farat vajore; bimët industriale apo medicinale; kashta dhe foragjere | 896 | 377 | -58 | 2,061 | 1,847 | -10 |
| 13 | Lënda e trashë ngjitëse nga të çarat e drunjëve; | | | | 8 | 6 | -26 |
| 14 | Materialet vegetale që përdoren për thurje; | | | | 5 | 5 | -8 |
| 15 | Vajra dhe yndyrat bimore apo shtazore; | 1,120 | 1,399 | 25 | 13,374 | 22,242 | 66 |
| 16 | Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut etj. | 925 | 983 | 6 | 8,506 | 13,417 | 58 |
| 17 | Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij | 432 | 450 | 4 | 4,249 | 11,519 | 171 |
| 18 | Kakao dhe përgatitjet prej kakaos | 381 | 565 | 48 | 4,259 | 5,066 | 19 |
| 19 | Përgatitjet prej drithërave, miellit, niseshtes apo qumështit; | 903 | 1,134 | 26 | 21,802 | 28,874 | 32 |
| 20 | Përgatitjet prej perimeve, frutave, arroveve etj. | 2,272 | 4,129 | 82 | 6,077 | 8,644 | 42 |
| 21 | Përgatitje të ndryshme të ngrënshme | 491 | 825 | 68 | 9,015 | 13,320 | 48 |
| 22 | Pijet, alkoolet dhe uthulla | 20,740 | 25,426 | 23 | 33,557 | 61,165 | 82 |
| 23 | Mbetjet nga industrinë ushqimore; Ushqim foragjer për kafshë | 771 | 906 | 18 | 8,298 | 11,112 | 34 |
| 24 | Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit | 5 | 32 | 502 | 2,277 | 2,304 | 1 |
| | Gjithsej | 41,135 | 51,594 | 25 | 183,381 | 266,571 | 45 |

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Nga vendet që janë nënshkruese të marrveshjes së CEFTA-s, pjesëmarrje më të madhe në vlerën e eksportit në vitin 2021 ka pasur Shqipëria me 51.0%, përcjellur nga Maqedonia e Veriut me pjesëmarrje prej 24.1%, Serbia 17.7%, Mali Zi 4.1% dhe B. Hercegovina 3.1%.

Tabela 11: Eksporti në shtetet e CEFTA-s për kapitujt 01-24, vlera në '000 €

| Shteti | Eksport | | Pjesëmarrja e shtetit, 2021 (%) | Ndryshimi 2021/2021 (%) |
|--------------------|---------------|---------------|------------------------------------|-------------------------------|
| | 2020 | 2021 | | |
| B. Hercegovina | 1,373 | 1,593 | 3.1 | 16 |
| Mali i Zi | 1,504 | 2,140 | 4.1 | 42.3 |
| Maqedonia e Veriut | 9,428 | 12,452 | 24.1 | 32.1 |
| Moldavia | | 3 | | |
| Serbia | 6,149 | 9,117 | 17.7 | 48.3 |
| Shqipëri | 22,680 | 26,289 | 51.0 | 15.9 |
| Gjithsej | 41,135 | 51,594 | 100 | 25.4 |

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Nga vendet e CEFTA-s, pjesëmarrje më të madhe në vlerën e importit në vitin 2021 ka pasur Serbia me pjesëmarrje prej 56.9%, vijuar nga Maqedonia e Veriut me pjesëmarrje prej 22.0%, Shqipëria 12.4%, Bosna Hercegovina 6.5%, Mali i Zi 2.1% dhe Moldavia 0.1%. Në vitin 2021 ka pasur ndryshime në vlerë të importit midis shteteve krahasuar me vitin paraprak, kështu që në vitin 2021 nga disa vende vërehet një rritje importit: Serbia për 89%, Bosnja Hercegovina 85%, Mali i zi 26% dhe nga Shqipëria 19%. Rënie në vlerë të importit ka pasur nga Moldavia (58%) dhe Maqedonia e Veriut (4%).

Tabela 12: Importi nga shtetet e CEFTA-s për kapitujt 01-24, vlera në '000 €

| Shteti | Import | | Pjesëmarrja e shtetit, 2021 (%) | Ndryshimi 2021/2020 (%) |
|--------------------|----------------|----------------|------------------------------------|-------------------------------|
| | 2020 | 2021 | | |
| B. Hercegovina | 9,363 | 17,325 | 6.5 | 85 |
| Mali i Zi | 4,484 | 5,657 | 2.1 | 26 |
| Maqedonia e Veriut | 61,207 | 58,715 | 22 | -4 |
| Moldavia | 342 | 143 | 0.1 | -58 |
| Serbia | 80,129 | 151,668 | 56.9 | 89 |
| Shqipëri | 27,857 | 33,062 | 12.4 | 19 |
| Gjithsej | 183,381 | 266,571 | 100 | 45.0 |

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Eksporti i produkteve bujqësore në vendet e CEFTA-s

Produktet bujqësore të eksportuara në vendet e CEFTA-s që kanë pasur rritje në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020

Vlera e eksportit të produkteve bujqësore në vendet e CEFTA-s në vitin 2021 ka shënuar rritje krahasuar me vitin 2020 për 25.4 %. Në tabelën më poshtë janë paraqitur disa kapituj që kanë shënuar rritje në vlerë në krahasim me vitin 2020: Kapitulli 08 (Pemët dhe aroret e ngrënshme, lëvozhga e agrumeve ose shalqirit dhe pjeprit) ka pasur rritje në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 për 57%; Kapitulli 11 (Produktet e industrisë bluajtëse, maja e elbit apo drithërave tjera) po ashtu shënoi rritje për 89%; Kapitulli 15 (Vajëra dhe yndyrat bimore apo shtazore dhe produktet e nxjerra nga to) 25%; Kapitulli 18 (Kakao dhe përgatitjet prej kakaos) 48% si dhe në Kapitullin 20 (Përgatitjet prej perimeve, frutave, arroveve apo pjesëve të tjera të bimëve) paraqitet rritje prej 82%.

Tabela 13: Produktet bujqësore më të eksportuara në CEFTA që kanë pasur rritje në vitin 2020-2021, vlera në '000 €

| CN2 | Përshkrimi i kodit | Eksport 2020 | Eksport 2021 | Ndryshimi 2021/2020 (%) |
|-----|---|--------------|--------------|-------------------------|
| 08 | Pemët dhe aroret e ngrënshme; lëvozhga e agrumeve ose shalqirit dhe pjeprit | 4,213 | 6,614 | 57 |
| 11 | Produktet e industrisë bluajtëse; maja e elbit apo drithërave tjera; | 814 | 1,542 | 89 |
| 15 | Vajra dhe yndyrat bimore apo shtazore dhe produktet e nxjerra nga to; | 1,120 | 1,399 | 25 |
| 18 | Kakao dhe përgatitjet prej kakaos | 381 | 565 | 48 |
| 20 | Përgatitjet prej perimeve, frutave, arroveve apo pjesëve të tjera të bimëve | 2,272 | 4,129 | 82 |

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Produktet bujqësore të eksportuara në vendet e CEFTA-s, që kanë pasur rënie në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020

Vlera e eksportit të produkteve bujqësore sipas kapitujve që kanë pasur rënie janë paraqitur si në vijim: Kapitulli 07 (Perimet e ngrënshme dhe disa lloje të rrënjëve dhe të zhardhokëve) në vitin 2021 ishte 36% më e vogël se sa në vitin 2020, duke vazhduar me Kapitullin 12 (Farat vajore; bimët industriale apo medicinale, kashta dhe foragjere) me rënie prej 58%.

Tabela 14: Produktet bujqësore të eksportuara në CEFTA që kanë pasur rënie në vitin 2020-2021, vlera në '000 €

| CN2 | Përshkrimi i kodit | Eksporti 2020 | Eksporti 2021 | Ndryshimi 2021/2020 (%) |
|-----|--|---------------|---------------|-------------------------|
| 07 | Perimet e ngrënshme dhe disa lloje të rrënjëve dhe zhardhokëve | 3,083 | 1,988 | -36 |
| 12 | Farat vajore; bimët industriale apo medicinale; kashta dhe foragjere | 896 | 377 | -58 |

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Importi i produkteve bujqësore në vendet e CEFTA-s

Produktet bujqësore të importuara nga vendet e CEFTA-s që kanë pasur rënie në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020

Në vitin 2021 vlera e produkteve bujqësore në kapitujt 01-24, të importuar nga vendet CEFTA është rritur dukshëm dhe kur e bëjmë krahasimin me vitin 2020 rrjedh se në asnjë kapitull nuk ka pasur rënie në vlerë të importit.

Produktet bujqësore të importuara nga vendet e CEFTA-s, që kanë pasur rritje në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020

Shtim në vlerë të importit në vitin 2021 shfaqet në të gjithë kapitujt, por po i veçojmë disa nga to që kanë pasur rritje më të madhe: Kapitulli 15 (Vajra dhe yndyrat bimore apo shtazore dhe produktet e nxjerra nga to) shfaqen me rritje prej 166%; Kapitulli 16 (Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut apo prej krustaceve) 158%; Kapitulli 17 (Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij) 271%; Kapitulli 19 (Përgatitjet prej drithërave, miellit, niseshtes apo qumështit etj) 132% dhe Kapitulli 22 (Pijet, alkoolet dhe uthulla) 182%.

Tabela 15: Produktet bujqësore më të importuara nga CEFTA që kanë pasur rritje në vitin 2020-2021, vlera në '000 €

| CN2 | Përshkrimi i kodit | Importi 2020 | Importi 2021 | Ndryshimi 2021/2020 (%) |
|-----|--|--------------|--------------|-------------------------|
| 15 | Vajra dhe yndyrat bimore apo shtazore dhe produktet e nxjerra nga to | 13,374 | 22,242 | 166 |
| 16 | Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut apo prej krustaceve | 8,506 | 13,417 | 158 |
| 17 | Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij | 4,249 | 11,519 | 271 |
| 19 | Përgatitjet prej drithërave, miellit, niseshtes apo qumështit etj. | 21,802 | 28,874 | 132 |
| 22 | Pijet, alkoolet dhe uthulla | 33,557 | 61,165 | 182 |

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

1.1.3 Eksport - Importi me Vendet e tjera

Përveç dy grupeve të shteteve që janë vendet e BE-së dhe CEFTA-s, shkëmbim tregtar Kosova ka edhe me vendet e tjera. Vlera e eksportit të produkteve bujqësore në vitin 2021 të eksportuar në vendet tjera ishte 9.3 mil. €, që në krahasim me vitin 2020 ka pasur rritje për 23.2%. Importi në vitin 2021 kishte vlerë 232.0 mil. €, që shfaqet me rritje krahasuar me vitin 2020 për 30.9%. Rritje të eksportit në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 ka pasur në produktet që bëjnë pjesë në Kapitullin 07 (Perimet e ngrënshme dhe disa lloje të rrënjëve dhe zhardhokëve) 89%; Kapitullin 09 (Kafe, çaj, krem dhe erëza) 37%; Kapitullin 22 (Pijet, alkoolet dhe uthulla) 6%. Rritje e vlerës së importit paraqitet po ashtu në kapitullin 22 (Pijet, alkoolet dhe uthulla) 124% dhe Kapitullin 23 (Mbetjet nga industritë ushqimore, ushqim foragjer i përgatitur për kafshë) me rritje prej 166% si dhe rritje e vlerës në kapitujt tjerë që janë shfaqur në tabelën 17.

Tabela 16: Eksporti - Importi me Vendet e tjera për kapitujt 01-24, vlera në '000 €

| CN2 | Përshkrimi i kodit | Eksport 2020 | Eksport 2021 | Ndryshimi 2021/2020 (%) | Import 2020 | Import 2021 | Ndryshimi 2021/2020 (%) |
|-----------------|--|--------------|--------------|----------------------------|----------------|----------------|----------------------------|
| 01 | Kafshët e gjalla | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 02 | Mishi dhe pjesët e ngrënshme të kafshëve | 0 | 0 | 0 | 41,470 | 56,122 | 35 |
| 03 | Peshqit dhe krustacet, molusqet dhe kafshët e tjera jokurrizore ujore | 0 | 0 | 0 | 2,103 | 2,105 | 0 |
| 04 | Produkte të qumështit; vezët; mjalti natyral; | 138 | 175 | 27 | 736 | 962 | 31 |
| 05 | Produkte me origjinë shtazore | 0 | 0 | 0 | 942 | 1,527 | 62 |
| 06 | Drunjtë dhe bimët e tjera; lulet e prera dhe gjethet dekorative | 780 | 980 | 26 | 596 | 696 | 17 |
| 07 | Perimet e ngrënshme dhe disa lloje të rrënjëve dhe zhardhokëve | 263 | 499 | 89 | 8,651 | 11,830 | 37 |
| 08 | Pemët dhe aroret e ngrënshme, lëvozhga e agrumeve etj. | 529 | 533 | 1 | 21,297 | 23,598 | 11 |
| 09 | Kafe, çaj, krem dhe erëza | 714 | 978 | 37 | 17,190 | 18,742 | 9 |
| 10 | Drithërat | 0 | 0 | 0 | 1,176 | 353 | -70 |
| 11 | Produktet e industrisë bluajtëse; maja e elbit apo drithërave tjera etj. | 249 | 265 | 6 | 791 | 456 | -42 |
| 12 | Farat vajore; bimët industriale apo medicinale; kashta dhe foragjere | 173 | 246 | 42 | 4,945 | 6,174 | 25 |
| 13 | Lënda e trashë ngjitëse nga të çarat e drunjëve; | 0 | 0 | 0 | 92 | 98 | 6 |
| 14 | Materialet vegjetale që përdoren për thurje; | 0 | 0 | 0 | 2 | 19 | 958 |
| 15 | Vajra dhe yndyrat bimore apo shtazore; | 0 | 19 | 0 | 3,556 | 4,191 | 18 |
| 16 | Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut etj. | 0 | 0 | 0 | 3,900 | 3,962 | 2 |
| 17 | Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij | 241 | 379 | 57 | 6,699 | 11,597 | 73 |
| 18 | Kakao dhe përgatitjet prej kakaos | 733 | 1,031 | 41 | 2,904 | 3,543 | 22 |
| 19 | Përgatitjet prej drithërave, miellit, niseshtes apo qumështit; | 145 | 231 | 60 | 13,308 | 14,876 | 12 |
| 20 | Përgatitjet prej perimeve, frutave, arroveve etj. | 812 | 566 | -30 | 8,716 | 10,561 | 21 |
| 21 | Përgatitje të ndryshme të ngrënshme | 12 | 272 | 2,110 | 15,603 | 18,293 | 17 |
| 22 | Pijet, alkoolet dhe uthulla | 2,470 | 2,617 | 6 | 4,456 | 9,960 | 124 |
| 23 | Mbetjet nga industritë ushqimore; Ushqim foragjer për kafshë | 322 | 546 | 70 | 3,547 | 9,449 | 166 |
| 24 | Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit | - | - | 0 | 14,654 | 22,886 | 56 |
| Gjithsej | | 7,581 | 9,337 | 23 | 177,334 | 232,001 | 31 |

